



Informatë për shtyp - 320/04/2020

27.04.2020
faqe 1 nga 2

Landi dhe komunat i lirojnë prindërit nga pagesat - Pagesat për përkujdesjen e fëmijëve në kopshte dhe shkolla të hapura me përkujdesje të fëmijëve anulohen për muajin maj

Zyra e Shtypit të Kancelarisë
Shtetërore
40213 Düsseldorf
Telefon 0211 837-1134
0211 837-1405
oder 0211 837-1151

presse@stk.nrw.de
www.land.nrw

Qeveria e Landit informon:

Pandemia e koronës është për shumë familje një sfidë e madhe dhe paraqet ngarkesë të madhe posaçërisht për prindërit me fëmijë të vegjël parashkollor dhe ata shkollor. Për të përkrahur këta prindër në këtë situatë aktuale landi dhe komunat kanë liruar prindërit nga pagesat në gjithë landin NRW për muajtë prill dhe maj për përkujdesjen e fëmijëve në kopshte dhe shkolla të hapura me përkujdesje dhe oferta jashtëshkollore të fëmijëve. Me këtë prindërit nuk kanë nevojë të paguajnë për përkujdesjen e fëmijëve të tyre, pa marrë parasysh a e kanë marrë në shfrytëzim përkujdesjen apo jo, për muajin maj.

Zëvendësi i kryetarit të Qeverisë së Landit, ministri për fëmijë dhe familje Joachim Stamp tha: „Ne e kemi zgjeruar përkujdesjen urgjente të fëmijëve që nga dita e sotme edhe për fëmijët e prindërve të vetëm përkujdesës, të cilët janë të punësuar. Megjithatë këtë ofertë të përkujdesjes së fëmijëve në kopshte dhe shkolla të hapura nuk e kanë në shfrytëzim një pjesë e madhe e familjeve. Për këtë arsye duam t'i lirojmë nga pagesa familjet edhe për një pagesë mujore. Në të njëjtën kohë jemi duke punuar në koncepte, si të mund t'i hapim me hapa të vegjël ofertat e arsimit për fëmijët tanë.“

Ministrja Komonale Ina Scharrenbach deklaroi: „Ne kemi gjetur një marrëveshje të drejtë në kuptim të familjeve në Nordrhein-Westfalen. Qeveria e Landit ka aprovuar në këtë kohë të vështirë edhe financimin e mëtejshëm të institucioneve përkujdesëse dhe arsimore si dhe ne jemi të gatshëm, të marrim për sipër pagesat e liruar nga prindërit në të gjitha komunat. Kjo është një shenjë e fortë për përgjegjësi të përbashkët dhe bashkëpunim në Nordrhein-Westfalen.“

Ministrja për Shkollë dhe Arsim, Yvonne Gebauer nënvizoj: „Vendimi do të thotë, që edhe prindërit që duhet të paguajnë për përkujdesjen e fëmijëve në shkolla të hapura, dhe përkujdesjen pasdite si dhe përkujdesjet tjera janë të liruar nga pagesa për muajin maj.“

Në rast se keni pyetje drejtohuni tek zyrat për shtyp të ministrive:

Ministria për Fëmijë, Familje, Refugjatë dhe Integrim, telefoni 0211 837-2417.

Ministria për Shkollë dhe Arsim, telefoni 0211 5867-3505.

Ministria për Vendlindje, Komuna, Ndërtim dhe Barazi, telefon 0211 8618-4246.

Ky tekst i shtypit mund të gjendet përmes faqes së internetit të Qeverisë së Landit www.land.nrw

[Udhëzime për mbrojtjen e datave lidhur me mediat sociale](#)